

KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Sot, më 31/10/2020 u paraqitën personalisht palët e mëposhtme:

SHITËSI: **Znj. Denisa Bishyti**, shtetase shqiptare, e lindur më 25.07.1984 në Fier, Shqipëri, banuese në Tiranë dhe mbajtëse e pasaportës nr. I45725097L, me cilësinë e ortakës së vetme të shoqërisë MSE SHPK (referuar në vijim si “**Shitësi**”);

dhe

BLERËSIT: 1. **Znj. Ilda Tërshana**, e bija e Sakip, e datëlindjes 19 qershor 1982 shtetas shqiptar, lindur në Kavajë dhe banues në Tiranë, identifikuar me nr personal I25619061W.
2. **Z. Arbër Liçaj**, i biri i Bilalit, i datëlindjes 03.05.1985, shtetas shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, identifikuar me Numer personal I50503079J.
3. **Z. Can Kutay Orten**, i biri i Aliut, i datëlindjes 28.09.1980, shtetas turk, lindur në Sungurlij dhe banues në Tiranë , identifikuar me Numer personal 41068884942.

Referuar në vijim si “Blerësit”.

Shitësi dhe Blerësi në vijim do të referohen veçmas si “**Palë**” dhe, bashkarisht si “**Palët**”.

Meqënëse:

- A. Shitësi është pronari i ligjshëm dhe i vetëm i kuotës që përfaqëson 100% të kapitalit bazë të **MSE SHPK**, një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (“**QKB**”) më datë 01.08.2018, me NIPT L82001005A, me seli në Autostrada Tiranë-Durrës, Kilometri 8, Rruga Paralele, Ndërtesë Private me zonë kadastrale 2105, Kashar, Tiranë (“**Shoqëria**”).
- B. Me Vendimin nr.4 , datë 12.10.2020 të Ortakut të Vetëm të shoqërisë, MSE SHPK ka vendosur shitjen e 100% të kuotës të zotëruar nga ortaku Blerësve në këtë kontratë.
- C. Znj.Ilda Tërshana si individë, ka shprehur vullnetin e saj për të blerë respektivisht 80% (tetëdhjetë përqind) të kuotës së zotëruar nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë MSE SHPK, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.
- D. Z.Arbër Liçaj dhe Z.Can Kutay Orten si individë, kanë shprehur vullnetin e tyre për të blerë secili respektivisht 10% (dhjetë përqind) të kuotës së zotëruar nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë MSE SHPK, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

Për këto arsye, referuar parashikimeve të neneve 72, 73/1, gërma b), 73/2 dhe 74 të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), si dhe nenin 5 të Statutit të shoqërisë MSE SHPK, palët e mësipërme lidhin këtë Kontratë për shit-blerjen e kuotës:

Neni 1 **Objekti i Kontratës**

- 1.1. Objekt i kësaj kontrate është shitja e kuotës së zotëruar nga Shitësi në shoqërinë MSE SHpk. Blerësve kundrejt çmimit dhe kushteve të përcaktuara në këtë kontratë, sipas pjesëve të mëposhtme:
- 1.1.1. 80% (tetëdhjetë përqind) e kuotës të zotëruar nga Shitësi në kapitalin bazë të shoqërisë MSE SHPK do t'i shitet Znj.Ilda Tërshana;
 - 1.1.2. 10% (dhjetë përqind) e kuotës të zotëruar nga Shitësi në kapitalin bazë të shoqërisë MSE SHPK do t'i shitet Z.Arbër Liçaj;
 - 1.1.3. 10% (dhjetë përqind) e kuotës të zotëruar nga Shitësi në kapitalin bazë të shoqërisë MSE SHPK do t'i shitet Z.Can Kutay Orten.


Neni 2 **Çmimi dhe pagimi i tij**

- 2.1. Çmimi i shitjes së 80% (tetëdhjetë përqind) të kuotës në kapitalin bazë të shoqërisë MSE SHPK nga Shitësi tek Znj.Ilda Tërshana është 5,699,000Lekë (pesë milion e gjashtëqindnëntëdhjetënëntëmijë Lekë).
- 2.2. Çmimi i shitjes së 10% (dhjetë përqind) të kuotës në kapitalin bazë të shoqërisë MSE SHPK nga Shitësi tek Z.Arbër Liçaj është 586,700 Lekë (pesëqindtetëdhjetëegjashtë mijëshatatëqind Lekë).
- 2.3. Çmimi i shitjes së 10% (dhjetë përqind) të kuotës në kapitalin bazë të shoqërisë MSE SHPK nga Shitësi tek Z.Can Cutay Orten është 712,000 Lekë (shtatëqinddymbjetëdhjetë mijë Lekë).
- 2.2. Çmimi i kuotës sipas pikave 2.1. – 2.3. të kësaj kontrate do t'i paguhet Shitësit nga secili prej Blerësve brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga data e lidhjes së kësaj kontrate në llogarinë bankare të Shitësit pranë BKT Bank SHA, me të dhënat që vijon:

Emri Bankes: BKT
IBAN: AL5920511306005084CLIDCLALLE
SWIFT: NCBAALTX .

Neni 3 **Kalimi i pronësisë mbi kuotën**

- 3.1. Kalimi i pronësisë mbi Kuotën objekt i kësaj kontrate nga Shitësi tek secili Blerës kryhet me nënshkrimin e kësaj kontrate.



- 3.2. Palët deklarojnë se regjistrimi i kësaj kontrate në regjistrat përkatës dhe vendimi i Ortakut të Vetëm të shoqërisë MSE SHPK për miratimin e saj nuk përbëjnë kushte për kalimin e pronësisë objekt i kësaj kontrate.
- 3.3. Me kalimin e pronësisë mbi kuotat nga Shitësit tek Blerësit sipas pikës 3.1. të kësaj Kontrate, kapitali bazë i shoqërisë MSE SHPK do të përbëhet nga 3 (tre) kuota, si vijon:

Kuota I – e cila do të përbëjë 80 % (tetëdhjetë përqind) të kapitalit bazë të shoqërisë në vlerën prej 4,693,600 (Katërmiliongjashtëqindnëntëdhjetëetremijëgjashtëqind) Lekë, e zotëruar nga ortaku Znj. Ilda Tërshana

Kuota II – e cila do të përbëjë 10 % (dhjetë përqind) të kapitalit bazë të shoqërisë në vlerën 586,700 (pesëqindtetëdhjetëgjashtëmijështatëqind) Lekë, e zotëruar nga ortaku Z. Arbër Liçaj;

Kuota III – e cila do të përbëjë 10 % (dhjetë përqind) të kapitalit bazë të shoqërisë në vlerën 586,700 (pesëqindtetëdhjetëgjashtëmijështatëqind)lekë, e zotëruar nga ortaku Z. Can Cutay Orten

Me kalimin e pronësisë mbi kuotën nga Shitësi tek Blerësit, Shitësi humb të drejtat e tij si ortak i shoqërisë MSE SHPK, ndërsa Blerësit mund të ushtojnë të drejtat e tyre si ortakë të kësaj shoqërie.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

- 4.1. Palët në këtë kontratë bien dakord të respektojnë kushtet dhe afatet e parashikuara në të.
- 4.2. Shitësi deklaron se është pronar i vetëm dhe i ligjshëm i kuotës së zotëruar në kapitalin bazë të shoqërisë MSE SHPK dhe se vendimmarrja për shitjen e saj është marrë në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore të shoqërisë.
- 4.3. Blerësit marrin përsipër të paguajnë çmimin e shitjes në vlerën dhe afatet e përcaktuara në nenin 2 të kësaj Kontrate.
- 4.4. Secili nga Blerësit pranojnë dhe marrin përsipër që drejtëpërdrejtë apo indirekt, personalisht apo nëpërmjet familjarëve apo personave të afërt deri në shkallë të katërt, të mos kryejnë si person fizik apo juridik, asnjë veprimtari tregtare të njëjtë, të ngjashme apo të tillë që konkuron në çfarëdolloj forme aktivitetin e shoqërisë MSE SHPK në fushën e shitjes dhe mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore dhe dentare.

Neni 5

Regjistrimi i kontratës

- 5.1. Palët autorizojnë Z. Arbër Liçaj, administratorin e shoqërisë MSE SHPK dhe/ose çdo person të autorizuar prej tij të regjistrojë këtë kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) brenda 30 (tridhjetë) ditëve të nënshkrimit të saj, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët e shoqërisë tregtare” (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Neni 6
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 6.1. Palët deklarojnë se çdo konflikt që mund të rrjedhë nga zbatimi apo interpretimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me marrëveshje mes tyre.
- 6.2. Nëse palët nuk arrijnë të zgjidhin me marrëveshje konfliktet eventuale, kompetente për shqyrtimin e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën shqipe dhe anglze në 4 (katër) kopje identike.

PALËT KONTRAKTORE:

SHITËSI

Ortaku i vetëm i shoqërisë MSE SHPK,

ZNJ.DENISA BISHYTI


Denisa Bishyti 

BLERËSIT

Znj.Ilda Tërshana

Ilda Tërshana 

Z.ARBËR LIÇAJ

Arbër Liçaj 

Z.CAN CUTAY ORTEN

Can Kutay Örtten 